

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7908
E enjte, 17 tetor 2024
Çmimi 0.50

Ndërroi jetë komandanti i parë i KFOR-it, gjenerali Sir Mike Jackson



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PUSHTETI E BOJKOTON SËRISH KUVENDIN, OPOZITA VENDOS NË ULËSET E TIJ KAPELA TË ZEZA

FAQE 4-5



Deputetët e partive opozitare, pa praninë e pushtetarëve, të mërkurën kanë mbajtur seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës. Ata kanë debatuar për keqpërdorimet e rreth 11 milionë eurove të faljes së kundërligjshme

të borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit nga qeveria Kurti dhe për bisedat e kundërligjshme të Dejana Mihalit për sistemin energjik. Për mospjesëmarrjen e deputetëve të pushtetit, PDK-ja ka zhvilluar një

aksion simbolik, duke vendosur kapela të zeza në ulëset e tyre, pas publikimit të mesazheve të Mihalit, e cila e këshillonte ish-kryeshëfën e KEK-ut, Nagip Krasniqi, t'i shkonte në një takim me kapelë

ME SHARJE DHE OFENDIME DREJT ZGJEDHJEVE TË SHKURTIT

F. 3



NUK DO TË NDALET LUFTA PËR DREJTËSI PËR VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE

F. 3




RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



ZUMBERI: NDIHEM SUPERIOR NDAJ KUNDËRSHTARËVE, SYNOJ MAJAT NË SPORT

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania thirr takim në OKB për Gazën, shqyrton sanksionimin e ministrave izraelitë

LONDËR, 16 TETOR - Britania e Madhe dhe Franca kanë thirrur një takim urgjent të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të diskutuar për gjendjen humanitare në Rripin e Gazës. Ndërkohë, Britania është duke shqyrtuar edhe sanksionimin e dy ministrave izraelitë, tha të mërkurën kryeministri britanik Keir Starmer.

Furnizimi me ushqim në Gazë ka shënuar rënie të madhe në javët e fundit, pasi autoritetet izraelite vendosën rregulla të reja doganore. Kjo gjendje e nxiti ShBA-në ta paralajmërojë Izraelin se, nëse nuk e përmirëson gjendjen, mund të përballet me kufizimin e

ndihmës ushtarake nga ajo. "Ne vazhdimisht po i pasqyrojmë këto me partnerët tanë", tha Starmer në Parlament kur u pyet për gjendjen në Gazë. "Ka kohë që nevojitet dhe nevojitet edhe tani urgjentisht futja e më shumë ndihmave në Gazë", tha ai.

Sekretari i Jashtëm i Britanisë, David Lammy, tha në një komunikatë se Izraeli duhet të sigurohet që civilët të mbrohen dhe që rrugët të jenë të hapura për ta lejuar ndihmën jetike të kalojë. Ai theksoi se këto çështje do të diskutohen në takimin e OKB-së.

Starmer theksoi se Britania po shqyrton sanksionimin e ministrit të Financave të Izraelit, Bezalel Smotrich, dhe atë të



Sigurisë Kombëtare, Iamar Ben-Gvir, për shkak të komenteve të tyre në lidhje me konfliktin.

Edhe ish-sekretari i Jashtëm, David Cameron, kishte shqyrtuar sanksionimin e

dysjes, para se Partia e Konservatore t'i humbte zgjedhjet në qershor.

I pyetur nëse qeveria do t'i sanksionojë Smotrichin, që tha se t'i lësh civilët në Gazë të vdesin urie mund të arsyetohet, dhe Ben-Gvirin, që tha se përgjegjësit e dhunës së kolonëve në Bregun Perëndimor janë heronj, Starmer tha: "Jemi duke e shqyrtuar këtë, sepse këto janë, natyrisht, komente të neveritshme". "Izraeli duhet t'i ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për ta shmangur vrasjen e civilëve, të lejojë sasi shumë më të mëdha të ndihmës në Gazë dhe t'ua mundësojë partnerëve të OKB-së të veprojnë në mënyrë efektive", tha Starmer.

Zelensky paraqet "Planin e fitores" që përfshin kërkesën për anëtarësim në NATO

KIEV, 16 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka paraqitur një plan, që ai beson se do ta ndryshonte kahun e luftës në të mirë të Kievit, dhe do të mund t'i jepte fund konfliktit me Rusinë, jo më larg se vitin e ardhshëm.

Në një fjalim të mbajtur para Parlamentit ukrainas më 16 tetor, Zelensky ka bërë thirrje që "partnerët t'i heqin kufizimet për përdorim të armëve me rreze të gjatë në gjithë territorin ukrainas të pushtuar nga Rusia, në territorin rus dhe në infrastrukturën ushtarake të armikut", dhe të ofrohet ndihmë në "furnizim të brigadave rezervë".

Në "Planin e fitores" të përbërë prej pesë pikave, ai ka e ka hedhur poshtë mundësinë e



copëtimit të territorit ukrainas, dhe ka bërë thirrje që Kievit të ftohet për t'u bashkuar aleancës ushtarake të NATO-s, dhe që Kievit të pajisjet me një paketë strategjike parandaluese

jobërthamore.

Lideri ukrainas ka thënë se do t'i prezantojë hollësitë e planit të enjten në një samit të Bashkimit Evropian që do të mbahet në Bruksel. Ai ka thënë se planin e ka

diskutuar me liderë të Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Italisë dhe Gjermanisë.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë se Ukraina duhet të "kthjellët", dhe e ka akuzuar Zelenskyn se vetëm e ka "kamuflyuar" një plan amerikan.

Moska kundërshton hapur anëtarësimin e Ukrainës në NATO dhe një mundësi të tillë e përdor si pretekst pse e ka nisur luftën në Ukrainë në shkurt të vitit 2022.

Kievi ka pritur të marrë një përgjigje për planin, në një takim që ishte planifikuar të mbahet në bazën Ramstein javën e kaluar në Gjermani, mirëpo takimi është shtyrë për shkak se presidenti amerikan Joe Biden e ka anuluar udhëtimin për shkak të uraganit

Milton.

Zelensky ka thënë se pret përgjigje për planin para zgjedhjeve presidenciale të 5 nëntorit në Shtetet e Bashkuara - vendin që ofron përkrahjen më të madhe financiare dhe ushtarake për Kievin, meqë një fitore e kandidatit republikan Donald Trump mund ta zbehë përkrahjen e Uashingtonit.

Prezantimi i Zelenskyt vjen teksa Rusia vazhdon ta rrisë presionin në qytetet dhe infrastrukturën ukrainase, dhe derisa ushtria ruse avancoi në qytetëzën e rëndësishme Pokrovsk.

Më 16 tetor, Rusia e ka sulmuar Ukrainën me 136 dronë dhe dy raketa.

Forca ajrore ukrainase ka thënë se shumica e raketave janë rrëzuar prej sistemit për mbrojtje ajrore.

Irani paralajmëron përgjigje "të vendosur" nëse e sulmon Izraeli

TEHRAN, 16 TETOR - Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, e ka paralajmëruar shefin e Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, që Teherani është gati për përgjigje "të vendosur" nëse Izraeli sulmon shtetin e tij, si hakmarrje për sulmin me raketa.

Republika Islamike ka lëshuar 200 raketa drejt Izraelit më 1 tetor si hakmarrje për vrasjet e dy aleatëve të tij të ngushtë, liderin e Hamasit, Ismail Haniyeh dhe liderin e Hezbollahut, Hassan Nasrallah, si dhe një general iranian.

Lindja e Mesme vazhdon të jetë e alarmuar nga përshkallëzimi i mundshëm i luftës teksa Izraeli lufton grupet e mbështetura nga Irani, Hezbollahun në Liban dhe Hamasin - grup palestinez i shpallur terrorist nga Shtetet e

Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë.

Hezbollahu, grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe në jug të Libanit, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, derisa Bashkimi Evropian e ka në listë të zezë vetëm krahun e armatosur, por jo partinë e cila ka ulëse në Parlamentin e Libanit.

Ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, është zotuar javën e kaluar që masat hakmarrëse të vendit të tij do të jenë "vdekjeprurëse, precize dhe befasuese". "Irani, duke bërë përpjekje për ta mbrojtur paqen dhe sigurinë në rajon, është plotësisht i përgatitur për një përgjigje të vendosur" ndaj Izraelit, ka thënë ministri Araghchi gjatë një bisede telefonike me



Guterresin. Përgjatë thirrjes telefonike,

Araghchi u ka bërë thirrje Kombeve të Bashkuara për t'i

përdorur të gjitha resurset "për t'u dhënë fund krimeve dhe agresionit të regjimit izraelit dhe për të dërguar ndihmë humanitare në Liban dhe Gazë".

Diplomati i lartë iranian ka biseduar përmes telefonit edhe me homologun e tij francez Jean-Noel Barrot.

Përgjatë thirrjes, Araghchi e ka përmendur nevojën e ndaljes së sulmeve izraelite në Liban, ka paralajmëruar kundër "aventurave të reja" të armikut të përbetuar dhe ka bërë thirrje për largim të "pengesave" izraelite për të dërguar ndihma te personat e zhvendosur. Në javët e fundit, Araghchi i ka vizituar Libanin, Sirinë, Arabinë Saudite, Katarin, Irakun dhe Omanin në përpjekje për t'i ulur tensionet.

Nuk do të ndalet lufta për drejtësi për viktimat e dhunës seksuale

PRISHTINË, 16 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është zotuar se nuk do të ndalet lufta për drejtësi, për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Numri i saktë i grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë nuk dihet, por përgjatë viteve të pasluftës organizata të ndryshme vendëse e ndërkombëtare kanë thënë se numri mund të arrijë deri në 20 mijë.

Osmani ka thënë të mërkurën se dhunuesit menduan që përmes dhunës seksuale mund ta çnderojnë Kosovën, por "në fakt asnjëherë nuk kanë arritur dhe nuk do të arrijnë të bëjnë një gjë të tillë". "Ju jeni heroinat, ju jeni krenaria dhe ju jeni vetë nderi i Kosovës", ka thënë Osmani, duke iu drejtuar viktimave. Ajo i ka bërë këto deklarata në konferencën ndërkombëtare mbi dhunën seksuale në konflikt, të organizuar për 25-vjetorin e Qendrës Kosovës për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Presidentja Osmani e ka falënderuar Qendrën për punën e bërë, dhe ka thënë se ajo ka shërbyer ndër vite si shtëpi e sigurt dhe vendstrehim për viktimat të panumërta, që kanë gjetur mbështetjen dhe janë siguruar që mund të flasin para popullit të Kosovës dhe para botës për atë që u ka ndodhur. "Duhet të luftojmë që historia mos të përsëritet. Padrejtësitë asnjëherë nuk duhet të kalojnë në heshtje, dhe drejtësia, e dimë të gjithë, nuk arrihet pa i mbajtur autorët përgjegjës për krimet e bëra. Fokusi ynë i përbashkët duhet të jetë te lufta

për drejtësi".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka vlerësuar lart viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, duke thënë se përkundur traumave të pashlyeshme, "të mbijetuarat kanë treguar forcë të jashtëzakonshme për të nisur jetë të re".

Feride Rushiti, udhëheqëse e Qendrës, e ka përmendur periudhën e pas luftës dhe vështirësitë e mëdha. "Periudha pas luftës ka qenë shumë e vështirë. Stigma që përjetonin gratë e mbijetuara të dhunës seksuale, heshtja, turpi në familje, ishte shumë e vështirë për t'u ballafaquar", ka thënë ajo.

Vasfije Krasniqi - Goodman, gruaja e parë që ka treguar publikisht se ka qenë viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, ka thënë se duhet bërë më shumë për të mbijetuarat dhe ka kritikuar autoritetet e Kosovës për procedurat që kanë hartuar për ta konfirmuar statusin e një viktime.

Ajo ka thënë se është e vështirë për viktimat që të dëshmojnë diçka që ka ndodhur 25 vjet më parë. "Dikush të të thotë në fytyrë që 'nuk je e mbijetuar', edhe ai është një lloj përdhunimi, kur të mohohet", ka thënë Krasniqi, e dërguar e posaçme e presidentes Osmani për t'i adresuar çështjet e dhunës seksuale gjatë luftës.

Pjesë e konferencës ka qenë edhe Denis Mukwege, laureat i Çmimit Nobel për Paqe. Edhe ai ka thënë se duhet të ndalet mospranimi dhe përjashtimi i viktimave të dhunës seksuale prej shoqërisë, pasi diçka e tillë



ritraumatizon viktimat. "Viktimat nuk janë kurrë fajtoare për krimet që kanë përjetuar" ka thënë Mukwege.

Ai i ka bërë thirrje shtetit të Kosovës që të përkujdeset për këtë kategori të personave, t'ua ofrojë mbrojtjen që dikur nuk ka mundur t'ua ofrojë, dhe që aty të përfshihet e drejta për drejtësi, për të vërtetën, dëmshtëpërlimet dhe garancitë për mospërsëritje të rasteve.

Marrja e statusit u siguron përfituesve një pension prej 230 eurosh në muaj dhe disa përfitime, si: lirim nga tatimi në pronë, përparësi në punësim,

shërbime shëndetësore etj.

Në shenjë mbështetjeje për të mbijetuarit, Kosova ka shpallur 14 prillin Ditë Kombëtare të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale nga Koha e Luftës.

Por, sipas të dhënave nga nëntori i vitit të kaluar, vetëm gati 2 000 persona kanë aplikuar për ta marrë statusin e personit të dhunuar gjatë luftës në Kosovë. Prej tyre, statusi u është aprovuar rreth 1 600 personave. Verifikimi i dëshmitave të personave që duan ta marrin këtë status - gjatë periudhës nga 27 shkurti i vitit 1998 e deri më 20 qershor të vitit 1999 - bëhet

nga Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës në Kosovë.

Fillimisht, aplikuesve u kërkohet ta plotësojnë një formular dhe të grumbullojnë disa dokumente: raport mjekësor, raport psikologjik, raport juridik, deklaratë e dëshmitarit, fotografi që dëshmojnë lëndimet trupore, artikuj të gazetave...

Në rast se Komisioni dëshiron sqarime shtesë për aprovimin e kërkesës, atëherë aplikuesit i kërkohet të paraqitet personalisht para Komisionit.

Përkujtohet heroi Adrian Krasniqi



PEJË, 16 TETOR - Të mërkurën është shënuar 27-vjetori i rënies së heroit Adrian Krasniqi. Homazhe te shtatorja e tij në Pejë ka bërë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Adrianin e kishte mik dhe bashkëluftëtar në ditët e

lavdisë.

Haradinaj ka thënë se Adrianin ishte një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Adrianin e kisha mik dhe bashkëluftëtar në ditët e lavdisë. I edukuar, zemërbardhë, guximtar i pashoq, ai

mishëronte frymën e lirisë për të cilën luftuam dhe për të cilën ai dha jetën. Një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, krah për krah me vëllezërit e armëve - Adrianin u angazhua në aksione kundër armikut, që shënuan

historinë tonë. Rënia e tij heroike, përpara se lufta të shpërthente plotësisht në Dukagjin, ndonëse një humbje e madhe, u shndërrua në një burim frymëzimi për të gjithë ne. Në këtë 27-vjetor, kur përkrah Nënës Mejreme

kujtuam e nderuam Adrianin, riafirmojmë zotimin tonë për një Kosovë të fortë dhe të begatë. Kujtimi i Adrianit dhe i të gjithë atyre që ranë për liri do të na udhëheq drejt një të ardhmeje më të ndritur për kombin tonë", ka thënë Haradinaj.





Pushteti e bojkoton sërish Kuvendin, opozita vendos në ulëset e tij kapela të zeza

Deputetët e partive opozitare, pa praninë e pushtetarëve, të mërkurën kanë mbajtur seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës. Ata kanë debatuar për keqpërdorimet e rreth 11 milionë eurove të faljes së kundërligjshme të borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit nga qeveria Kurti dhe për bisedat e kundërligjshme të Dejana Mihalit për sistemin energjik. Për mospjesëmarrjen e deputetëve të pushtetit, PDK-ja ka zhvilluar një aksion simbolik, duke vendosur kapela të zeza në ulëset e tyre, pas publikimit të mesazheve të Mihalit, e cila e këshillonte ish-kryeshefin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, t'i shkonte në një takim me kapelë

“Përhëndetje deputetë, z. kapuça të zi ose zotëri me kapuça të zi dhe të dashur qytetarë dhe media”, ka thënë Haliti teksa ka vazhduar kritikën për qeverinë Kurti.

Deputeti nga radhët e LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se Qeveria e Kosovës është e zhytur në korrupsion. Zemaj gjatë

seancës së jashtëzakonshme, e cila është thirrur nga opozita për procesin e përlogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka thënë se edhe deputetët e LV-së do të duhej të

ishin pjesë e kësaj seance që të dëgjonin se çfarë ka bërë kjo qeveri. “Nga shqetësimet tona është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme. Edhe deputetët e LV-së do të duhej të ishin këtu e të dëgjonin për korrupsionin e madh që e ka bërë kjo qeveri. Vetë fakti tregon se kjo qeveri nuk i ka duart e pastra, i ka



EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë zhvilluar të mërkurën një aksion simbolik në Kuvendin e Kosovës. Ata kanë vendosur kapela të zeza në ulëset e deputetëve të LV-së, të cilët e kanë bojkotuar seancën e jashtëzakonshme që ishte thirrur më 16 tetor nga opozita. Ky aksion vjen pas publikimit të disa bisedave të koordinatores për komunitete të LV-së, Dejana Mihali, me ish-drejtorin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, ku në njërin nga këto biseda të publikuara në

medie shihej se Mihali i është drejtuar Krasniqit se “a po vjen me kapele”.

Shefi i deputetëve të PDK-së, Abelard Tahiri, u shpreh se për t'iu folur këtyre kapelave, është njëjtë sikurse t'iu folësh deputetëve të LV-së. “As sot pushteti nuk erdhi në Kuvend për t'iu ballafaquar me aferat ku janë përfshirë. Kanë vendosur të fshihen pas kapelave. Por pas tyre nuk do të mund të fshihen gjatë. Ditët e qeverisjes ‘incognito’ do të marrin fund së shpejti”, ka thënë Tahiri.

Deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti, ka ironizuar me deputetët e Vetëvendosjes të cilët nuk po marrin pjesë në këtë seancë.

Ndërroi jetë komandanti i parë i KFOR-it, gjenerali Sir Mike Jackson

PRISHTINË, 16 TETOR - Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë ka njoftuar se ka vdekur gjenerali britanik Sir Mike Jackson, komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë.

Gjenerali Sir Mike Jackson ishte pjesë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor 1999 ndërmjet autoriteteve të NATO-s, të udhëhequra nga gjenerali britanik dhe ish-shefit të Shtabit të Armatës së Serbisë, gjeneralit Nebojsa Pavković, më vonë i akuzuar i Hagës për krime lufte dhe gjenocid. Me këtë marrëveshje, Serbia është detyruar t'i tërheqë të gjitha forcat e saj policore dhe ushtarake nga Kosova. Vetëm tri ditë më vonë, gjenerali britanik iu priu rreth 40 mijë trupave ushtarake të 26 vendeve të ndryshme, që hynë në Kosovë në kuadër të KFOR-it.


Jackson ishte bërë lajm ndërkombëtar më 12 qershor të

vitit 1999 kur kishte refuzuar urdhrin e Wesley Clarkut, komandantit të Forcave të NATO-s për Evropë, për t'i sulmuar trupat ruse, të cilat ishin vendosur në Aeroportin e Prishtinës. "Nuk do tani Luftën e Tretë Botërore", raportohet t'i ketë thënë atëkohë Jackson Clarkut.

Gjenerali i famshëm britanik gjatë mandatit të tij kishte negociuar demilitarizimin e UÇK-së nga e cila kishin dala Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

Në njoftimin e Ambasadës së Britanisë shprehet pikëllim për vdekjen e gjeneral Sir Mike Jackson. "Gjeneral Sir Mike Jackson KCB CBE DSO lindi në vitin 1944 dhe u edukua në Shkollën Stamford, RMA Sandhurst dhe Universitetin e Birminghamit. Ai u gradua nga Sandhurst në Korpusin e Inteligjencës në dhjetor të vitit 1963, ndërsa studioi 'Studime Ruse' nga viti 1964 deri më 1967.

Pas diplomimit ai kaloi përkohësisht dy vjet në Regjimentin e Parashutistëve dhe më pas u transferua në Korpusin e Inteligjencës në vitin 1970. Gjatë fillimviteve '70 ai shërbeu në Irlandën e Veriut dhe me TA-në në Skoci. Ai ndoqi Kolegjin e Shtabit në vitin 1976, pas së cilit kaloi dy vjet si shef i Shtabit të Brigadës së Këmbësorisë së Berlinit. Më pas komandoi një kompani parashutistësh për dy vjet, përsëri në Irlandën e Veriut. Pas një kursi gjashtëmujor në Kolegjin Kombëtar të Mbrojtjes në Latimer në vitin 1981, ai iu bashkua stafit drejtues në Kolegjin e Shtabit. Turneu i tij dyvjeçar e gjysmë në Camberley përfshinte një lidhje 10 javore në Ministrinë e Mbrojtjes gjatë konfliktit në Ishujt Falkland", thuhet në postimin e ambasadës. Për vdekjen e Jacksonit kanë shprehur ngushëllime liderët e shtetit të Kosovës dhe ata opozitarë.



Gjykata e dënon edhe një person tjetër për sulmin ndaj KFOR-it

PRISHTINË, 16 TETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar L Lazar Dejanovićin me tetë muaj burgim dhe gjobë prej 10 000 eurosh pasi ai arriti marrëveshje me prokurorinë për pranimin e fajësisë lidhur me pjesëmarrjen në protestën e dhunshme të 29 majit 2023 në Zvečan, kur protestuesit serbë u përlëshën me pjesëtarët e KFOR-it, misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë.

Prokuroria Speciale e Kosovës e akuzoi Dejanovićin për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar dhe pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm.

Avokati i Dejanovićit, Lubomir Pantović, i tha Radios Evropa e Lirë se në dënimin e tij me burgim është përfshirë edhe koha që ai e ka kaluar në paraburgim prej 20 qershorit të këtij viti, që nënkupton se atij i kanë mbetur vetëm katër muaj burgim për t'i shlyer.

Përveç Dejanovićit, në Kosovë deri tani janë arrestuar edhe dhjetëra persona të tjerë për "pjesëmarrje



në protesta të dhunshme" dhe për sulm ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, por shumica kanë arritur marrëveshje me prokurorinë për pranimin e fajësisë.

Dhuna në Zvečan kishte

shpërthyer pasi serbët lokalë patën kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna në veri të Kosovës, të

banuara me shumicë serbe.

Si pasojë e dhunës kishin mbetur të plagosur 93 pjesëtarë të KFOR-it, disa prej tyre rëndë.

KFOR-i ka thënë më herët se sulmi ndaj ushtarëve të tij ishte kryer "pa

asnjë provokim" dhe se ishte "plotësisht i papranueshëm".

KFOR-i, gjithashtu, tha se shpresonte që edhe autoritetet në Beograd do t'i hetojnë personat që pas trazirave "u kthyen në Serbi", dhe se pret që të gjithë autorët të "procesohen me urgjencë". Institucionet përkatëse në Serbi deri më tani nuk janë deklaruar për këtë çështje, pra nuk dihet nëse autoritetet serbe po zhvillojnë ndonjë proces kundër personave që kanë marrë pjesë në sulmin ndaj KFOR-it.

Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet në Zvečan, duke thënë se ato janë kryer nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vučić".

Por, Serbia e ka mohuar një akuzë të tillë, duke e akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se synonte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n".

KFOR-i është përgjegjës i tretë për sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

të zhytura në korrupsion në shkallë të lartë", ka thënë Zemaj. Ai ka thënë se kjo skemë e krimit financiar e mirorganizuar dhe e strukturuar në qeveri dhe e kontrolluar nga politika e krimit duhet të zbardhet në prokurori. "LDK-ja do t'i shfrytëzojë të gjitha mekanizmat ligjorë dhe kushtetues për t'i zbardhur të gjitha pikat e korrupsionit në këtë qeveri", ka thënë Zemaj. Shefi i grupit parlamentar i AAK-

së, Besnik Tahiri, ka thënë se kjo qeveri nuk ka asnjë mundësi që ta mbrojë veten nga marrja që e ka kapluar Kosovën. "Nuk kanë mundësi për ta fshehur bashkëpunimin sekret, me të cilët kanë qenë në mburrje se nuk kanë koalicion me Listën Serbe. Nuk mund të dalin në ballë për t'u ballafaquar, sepse nuk kanë argumente. Kjo qeveri do të ikë më 9 shkurt. Do të ikë njëherë e përgjithmonë", ka

thënë Tahiri.

Deputeti Haki Abazi ka thënë se është për brengosje që në çdo ministri ekziston një individ që nuk i përgjigjet ministrit, qeverisë, komisionit parlamentar, por i përgjigjet një strukture jashtë institucioneve. Abazi para deputetëve të Kuvendit të Kosovës tha se edhe në Ministri të Mbrojtjes është spiuni i Dejana Mihalit. "Në çdo ministri ekziston një individ që

nuk i përgjigjet ministrit, qeverisë, rrjedhimisht komisionit parlamentar, por i përgjigjet një strukture jashtëinstitucionale atje dhe bart mesazhin dhe krijon diskursin publik, të cilën ia përcakton dikush jashtë institucioneve... Kjo është për brengosje", ka thënë Abazi. Seanca e opozitës u ndërpre me kërkesën e tyre, pasi RTK-ja nuk e transmetonte atë. "Asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që RTK-ja

të transmetojë një seancë të Kuvendit në kanalet alternative. Kjo ndodhi pikërisht sot, kur prisnim t'i adresonim aferat korruptive të këtij pushteti, duke dëshmuar kapjen e këtij mediumi nacional nga 'kapelat e Dejonës'. Përballë këtij akti, ne, shefat e grupeve parlamentare të opozitës, do t'u drejtohemi qytetarëve në një konferencë për medie", ka thënë deputeti i PDK-së, Abelard Tahiri.

ADOLF HITLERI: JETA, MIZORITË DHE VDEKJA E TIJ (3)

Hitleri paralajmëronte 'revolucionin racial gjerman'

Edhe në fillim të shekullit XXI vazhdojnë të jenë të hapura pyetje të ndryshme lidhur me rrethanat shoqërore, historike, politike, kulturore, psikologjike etj. të paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën botërore. Në këtë kuptim, me të drejtë shtrohen pyetjet: Cila ishte parahistoria e paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën politike? Cilat ishin parakushtet historike, kulturore etj. që mundësuan paraqitjen e nazizmit si ideologji dhe lëvizje politike dhe ushtarake? Çfarë lloj njeriu mund të planifikonte dhe të zbatonte plane dhe projekte aq vdekjeprurës për njerëzimin? Megjithatë, Adolf Hitlerit, diktatorit më të rrezikshëm të shekullit të XX, nuk i dihet varri, ndërsa në vendin e tij në Gjermani nuk ka përmendore!



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Djegia e Reichtagut

Universitetet gjermane u bënë vatra kryesore të fermetimit të vërtet hitlerian. Në shkurt të vitit 1930, Hitleri e emëroi Goebbelsin si shef të propagandës për të gjithë Gjermaninë dhe garantoi se nazistët do ta merrnin pushtetin, e shumta brenda tre vjetësh. Dhe kështu ndodhi në të vërtetë. Paraprakisht, Hitleri kishte deklaruar që i tërë pushteti duhej t'i jepej atij, ose pushteti zë mos ekzistoj fare. Më 30 janar 1933 Oskar von Hindenburgu, kryetar i shtetit gjerman u detyrua ta pranoi caktimin e Hitlerit si kancelar dhe ky, konform rregullit në fuqi, bëri betimin e besnikërisë përpara Kushtetutës së Weimarit.

Në mbrëmjen e po asaj dite, Hitleri, duke ngrënë darkën me Goebbelsin, Goeringun dhe të afërmit e tij të tjerë, e festoi atë

ditë të madhe "të revolucionit racial gjerman", që po inauguronte luftën finale të arianëve për sundim botëror.

Djegia e Reichtagut, më 27 shkurt, e ndryshoi shumë shpejt dhe papritmas krejt situatën në Gjermani. Parlamentit ia vuri zjarrin një komunist holandez, gjë që sipas historianëve me siguri ishte një provokacion. Duke përfituar nga ky rast, për të cilin edhe sot dyshohet se ishte përgatitur me lejen e kancelarit të ri të Gjermanisë, Hitleri e kishte detyruar Hindenburgun të firmoste një dekret "mbi mbrojtjen e popullit dhe të shtetit gjerman", që u bë ligj themelor i Reichut III. Të nesërmen, Partia Komuniste u akuzua se zjarrin e kishte vënë ajo dhe kështu u ndalua veprimtaria e saj. Në agim të asaj dite, repartet e sulmit (SA) arrestuan katër mijë kundërshtarë politikë, sidomos komunistë, dhe i dërguan në kampe përqendrimi të improvizuara. Arrestimet vazhduan edhe ditët që pasuan.

Në fund të vitit 1933, numri i të burgosurve të të gjitha kategorive ishte afërsisht njëqind mijë. Këta u arrestuan nga organi i sapoformuar që njihej me emrin Gestapo-ja.

Një veprim i mëtejshëm, i kurdisur nga Goebbelsi më 1 prill 1933, ishte bojkotimi i

dyqaneve të çifutëve. Në të gjithë vendin, grupe të reparteve të sulmit (SA) ndalonin hyrjen në këto dyqane. Parulla me shprehjen e njohur "Jashtë çifutët" ishin ngjitur gjithandej nëpër dyer e dritare. Në fillim të vitit 1934, pra pas largimit të Gjermanisë nga Lidhja e Kombeve, sundimtari i Reichut III dhe urdhër për riarmatimin e fshehtë të Gjermanisë. Antisemitizmi, i cili aso kohe edhe në Francë ishte i theksuar, ishte tjetër faktor nxitës në favor të synimeve hitleriane. Në fakt re të zeza po grumbulloheshin në qiellin e Gjermanisë.

Hitleri u bë burim i çdo ligji në Gjermani

Fyhreri ishte burim i çdo ligji në Gjermani. Në hierarkinë e kulteve në Rajhun e Tretë një vend qendror zë kultit i Hitlerit. Ai ishte absolut dhe i pakufizuar, në përputhje me pushtetin absolut dhe të pakufizuar të Fuehrerit. Gjithçka lidhej me personalitetin e Hitlerit. Përshëndetja zyrtare "Heil Hitler" e mbante emrin e tij pa pushim në gojë. Duke mbajtur fjalimin e tij të datës 24 qershor 1935, Goeringu deklaronte se: "Ai është gjithçka, ai është Gjermania, ai është lëvizja jonë, ai është e ardhmja jonë". Kurse Goebbelsi më 19 prill 1939 në fjalimin e tij, në mbledhjen solemne në Reichtag me rastin e 50 vjetorit të ditëlindjes së Hitlerit deklaronte: "Emri i Adolf Hitlerit është sot një program politik për tërë botën tonë. Atë e mbajnë si legjendë në tërë globin....Sot bota nuk mund të përfytyrohet dot pa të...Adolf Hitleri është sot garanti më domethënës i rendit të ri në Evropë".

Vitet 1936, 1937 ishin vitet e fundit të paqes së bresht. Më 5 nëntor 1937, Hitleri kishte thirrur për takim Goeringun, që ishte ministër i aviacionit, von

Blombergun ministër i luftës, von Fritschin, komandant suprem i ushtrisë dhe von Neurathin, ministër i punëve të jashtme, për tu besuar atyre planet e veta. Biseda me ta kishte zgjatur katër orë.

Hitleri gjykonte se po afrohej çasti i përshtatshëm për të vënë në jetë programin e "Mein Kampf". Gjatë takimit të sipërpërmendur katërorësh, ai kishte fiksuar madje edhe datat për pushtimin e hapësirës jetike të Lindjes. Kishte përcaktuar vitin 1938, si datë më të afërt, ose vitin 1945, si datë më të largët. Sipas Hitlerit më parë duhej pushtuar Austria dhe Çekosllovakia. Ideja sunduese e Hitleri mbetej gjithnjë formimi i një perandorie botërore, që do të dominonte dhe mbrohej nga bërthama racore gjermanike. Ishte mjaft e qartë se ky program i tij mund të realizohej vetëm përmes një lufte. Ndaj, edhe deklaronte se: "Vetëm mjetet e dhunës mund ta zgjidhin problemin gjerman". Von Neuati, von Blombergu dhe Fritchi, të frikësuar, paraqiten kundërshtimet e tyre Hitleri, i zëvendësoi Neurathin dhe Ribentropin. Po atë ditë Fyhreri e mori vetë detyrën e komandantit të përgjithshëm të ushtrisë.

Më 1938 Hitleri e ndjente veten aq të fortë sa të kapërcente kufijtë e vendosur në Versajë. Objektivi i tij i parë ishte vendi i tij i lindjes, Austria. Traktati i Versajës e ndalonte Austrinë, të bashkohej me Gjermaninë. Një muaj pas kërcënimeve naziste dhe koncesioneve e hezitimeve të Austrisë, trupat gjermane më 12 mars 1938 marshuan në Austri.

Protestat gjysmake të demokracive kundër aneksimit të Austrisë nga Gjermania, vështir se tregonin ndonjë shqetësim të vërtetë, përderisa nuk merrej asnjë masë konkrete. Ndërsa po binte kambana e vdekjes për


sigurimin kolektiv, Lidhja e Kombeve heshte. Demokracitë kishin shpresë se Hitleri do të ndalte marshimin e tij, meqë i kishte mbledhur në atdhe gjithë gjermanët etnikë. Por Hitleri nuk mjaftohej me këto pushtime. Si synim i radhë për Hitlerin ishte Çekosllovakia. Më 1938 Hitleri e ngriti tonin e retorikës së tij, duke kërcënuar se do t'ia aneksonte me forcë Rajhut gjerman landin e Sudetëve. Madje, Ruzvelti, vendi i të cilit ishte më i lidhuri me krijimin e Çekosllovakisë, në shtator të vitit 1938 sugjeroi zhvillimin e bisedimeve në një tokë neutrale. Më 15 shtator 1938 Çemberleni, kryeministër britanik u takua në Gjermani me Hitlerin. Mbas dëgjoi për disa orë fjalët e mëdha të Hitlerit për gjoja keqtrajtimin e gjermanëve të Sudetëve, Çemberleni pranoi që Çekosllovakia të copëtohej. Por Hitleri kishte dashur luftë, të cilën e konsideronte të domosdoshme për arritjen e ambicieve të tij. Ndaj nuk i mjaftoi as takimi i njohur i Munihut mbajtur më 29 shtator 1938 midis udhëheqësve të Gjermanisë, Italisë, Francës dhe Britanisë së Madhe.

Por, Hitlerit nuk iu desh shumë kohë për të shkatërruar iluzionet e paqësorëve. Në mars të vitit 1939, më pak se gjashtë muaj pas Munichut, Hitleri pushtoi atë që kishte mbetur nga Çekosllovakia. Pjesa çeke u bë protektorat gjerman; Sllovakia teknikisht u përcaktua shtet i pavarur, po të ishte satelit i Gjermanisë.

Shkatërrimi i Çekosllovakisë nuk kishte asnjë vlerë gjeopolitike; ai tregoi se Hitleri vepronte jashtë arsyes dhe shkente drejt luftës. Megjithatë, në bazë të parimeve të Versajës, pushtimi i Çekosllovakisë shënonte një pikë kulmore, sepse i tregonte që Hitleri kërkonte dominimin e Evropës dhe jo vetëvendosjen apo barazinë. (Vijon)



Me sharje dhe ofendime drejt zgjedhjeve të shkurtit



PRISHTINË, 16 TETOR - "Spiun", "tradhtar", "kriminel", "hajn" e "llasku"! Epitete të tilla, deputetët e Kuvendit të Kosovës i kanë mveshur lehtësisht njëri-tjetrit, sidomos në seancat e dy javëve të fundit.

Gjuha e tillë fyese dhe denigruese është përdorur edhe nga përfaqësues të pushtetit, edhe të opozitës, edhe nga burra, edhe nga gra.

Ajo ka kulmuar më 11 tetor, kur partia në pushtet - Lëvizja Vetëvendosje - ka mbivotuar kundër kërkesës së partive opozitare për një seancë të jashtëzakonshme, lidhur me përgjimin e një bisede telefonike, e cila, sipas opozitës, përfshin shefen e grupit parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, dhe ish-nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoičiq, tani i akuzuar për sulmin e armatosur në Banjskë.

Fyerjet atë ditë kanë qenë edhe personale.

Për disa analistë të politikës ato janë duke u shtuar me afrimin drejt zgjedhjeve parlamentare, që do të mbahen më 9 shkurt të vitit të ardhshëm. "Beteja për rritje apo mbajtje të elektoratit po bëhet në mënyrë të paskrupullit, duke dëgjuar çdo ditë akuzat apo kundërakuzat, me apo pa bazë", thotë për Radion Evropa e Lirë, Arton Demhasaj nga Organizata joqeveritare "Çohu".

Për Rrahman Paçarizin, profesor në Departamentin e Gazetarisë në

Universitetin e Prishtinës, gjuha e tillë denigruese bëhet e zakonshme në Kosovë përpara çdo procesi zgjedhor. "Diskursi është krejt i ngjashëm dhe zakonisht shkon kah një lloj nacionalizmi, kah një lloj përpjekjeje për të dëshmuar se cila parti është më nacionaliste apo më atdhetare", thotë ai.

Sipas të dy vëzhguesve, kjo gjuhë vetëm se e degjeneron diskursin parlamentar.

Çfarë thonë përfaqësuesit e partive politike?

Akuzojnë njëri-tjetrin, duke thënë se Kuvendi i Kosovës duhet të jetë vendi ku mbizotëron gjuha e argumenteve. Enver Dugolli, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, thotë për Radion Evropa e Lirë se gjuha e përdorur nga deputetët e kësaj partie është vetëm reagim ndaj gjuhës me të cilën u drejtohen kolegët nga opozita. "Nuk është se ndonjë deputet i pushtetit ka pasur iniciativë apo qëllim ta degradojë gjuhën karshi oponentëve. Është, thjesht, një lloj përgjigjeje ndaj gjuhës së përdorur [nga opozita]", thotë Dugolli për Radion Evropa e Lirë.

Abelard Tahiri, shef i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në opozitë, drejton akuzat të ngjashme kundër deputetëve të Vetëvendosjes. "Ky debat shkon duke u ashpërsuar

Çfarë thuhet në Kodin Penal?

Kodi Penal i Republikës së Kosovës nuk e përmend në mënyrë specifike gjuhën denigruese, por përcakton se "kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrë e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet".

për shkak të numrave nga shumica, në këtë rast nga Lëvizja Vetëvendosje. Sikur ta kishim një sjellje normale, ku do ta lejonin debatin dhe do t'i dëgjonin pretendimet e opozitës me qetësi, atëherë normalisht që nuk do të vinte deri të diskutimi aq i ashpër", thotë Tahiri.

Për Arben Gashin, shef i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë, gjuha denigruese - kushdo që e përdor - "është e gabuar". "Nuk u shërben asgjë qytetarëve të Kosovës dhe vetëm e polarizon skenën politike", thotë ai. Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i partisë tjetër në opozitë, Aleancës për Ardhmërinë

e Kosovës, thotë se debatet me gjuhë të ashpër janë karakteristike e parlamenteve të vendeve me demokraci. Por, sipas tij, AAK-ja nuk e mbështet gjuhën denigruese dhe "varet nga deputetët veç e veç se çfarë gjuhe përdorin". "Gjuha ofenduese duhet të dënohet. Ajo nuk duhet të jetë pjesë e diskutimeve këtu në Kuvend. Jemi pak para zgjedhjeve dhe unë nuk pres ndonjë diskutim më të ashpër, më të rëndë, mirëpo pres ballafaqim më të fortë ndërmjet opozitës dhe qeverisë", thotë Tahiri.

A po luhet me kartën nacionaliste?

Përfaqësuesit e partive politike, me të cilët bisedoi REL-i, thonë se jo. Ata pretendojnë kështu përkundër faktit se fjalët ofenduese dhe denigruese në adresë të njëri-tjetrit, deputetët e pushtetit dhe opozitës i kanë shprehur teksa kanë akuzuar njëri-tjetrin për bashkëpunim ose komunikim me Listën Serbe dhe ish-nënkryetarin e saj, Radoičiq. Sipas Demhasajt, përplasjet e partive parlamentare me akuzat "për bashkëpunim me Listën Serbe", rrezikojnë stigmatizimin e kësaj partie - që është më e madhja e serbëve në Kosovë - por edhe të partive të tjera të këtij komuniteti. "Krejt këto akuzat që po i shohim sot, të cilat po i bëjnë partitë politike ndaj njëra-tjetres... Ato nesër mund të

përfundojnë bashkë në një qeveri - këto mes vete e ndoshta bashkë edhe me Listën Serbe", thotë Demhasaj.

Por, ndryshe e sheh situatën Paçarizi. Sipas tij, Lista Serbe, e cila mbështetet dhe dirigjohet nga Beogradi zyrtar dhe politikat e tij, nuk mund të përjetohet më si partnere e besueshme nga partitë politike shqiptare. Ai thekson se përplasjet ndërmjet partive politike nuk kanë të bëjnë me ndonjë përpjekje për stigmatizim apo dobësim të Listës Serbe por me, siç thotë, mungesën e kreativitetit të tyre për të ndërtuar kauza apo për të nisur koncepte politike të qarta dhe të profilizuara mirë. "Për shkak të mungesës së kreativitetit, merren me çështje, të cilat janë më të lehta dhe më popullore, siç janë: rrahgjakset për patriotizëm, për atë se kush e ka çliruar veriu, a është çliruar veriu, a ka apo nuk ka sovranitet etj", thotë Paçarizi.

Të dy analistët thonë se degradimi i gjuhës së komunikimit parlamentar, në funksion të arritjes së efekteve politike, duhet shmangur.

Duke kujtuar se në të kaluarën ka pasur raste kur deputetët janë përleshur edhe fizikisht, ata thonë se gjuha dhe sjellja e tillë ka pastaj efekt zinxhiror edhe tek opinioni. "Ka rrezik të barten edhe te familjet e tyre, te qytetarët, të cilët mund të mos përmbahen dhe të reagojnë në mënyrë të papërgjegjshme", përfundon Paçarizi.

Nënshkruhet marrëveshja në vlerë mbi 12 milionë euro me KfW-në, synohet përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

Prishtinë, 16 tetor - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes një ceremonie ka nënshkruar marrëveshjen në vlerë mbi 12 milionë euro me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), për çka synohet përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.

Ky projekt është kontribut i Bashkimit Evropian i implementuar nga KfW.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, tha se kjo marrëveshje synon përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve duke garantuar një mjedisi më të pastër. Ai theksoi se projekti ka për qëllim të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në përpunim me parimet e mbrojtjes së mjedisit si dhe të kontrollojë depozitimin e mbetjeve sipas strategjisë kombëtare për

menaxhimin e mbetjeve.

“Marrëveshja në fjalë do të mundësojë ofrimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan, e që është pjesë e programit më të gjerë për menaxhimin e mbetjeve të forta. Projekti ka për qëllim të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në përpunim me parimet e mbrojtjes së mjedisit si dhe ta kontrollojë depozitimin e mbetjeve sipas strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve. Projekti synon të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve natyrore”, tha Murati.

Ndërkaq shefi i Departamentit të Evropës Juglindore të KfW, Klaus Muller, derisa vlerësoi rëndësinë e këtij projekti, theksoi se është urgjente që të merren veprime në këtë fushë. Sipas tij, niveli lokal dhe ai qendror duhet të punojnë së bashku që të tejkalohen problemet me mbeturina dhe se ky projekt të përfundohet me kohë. “Gjermania 20 milionë euro i ka alokuar për këtë projekt më



herët dhe tani kemi një fond të ri të IPA të BE-së. Kur jemi te deponitë, duke parë veprimet urgjente është me rëndësi që në nivelin lokal dhe qendror të punojmë së bashku që të tejkalojmë këto probleme dhe të

fillojmë me këtë projekt. Kosova drejt BE-së është duke punuar shumë në menaxhimin e deponive dhe janë duke u marrë shumë hapa në këtë drejtim”, tha Muller.

Drejtori gjeneral në Kompaninë

për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK), Dardan Veliaj, tha se ky projekt është qenësor për ndërmarrjen. Ai theksoi se nëpërmjet këtij programi gjendja e deponive sanitare pritet të ndryshojë.

Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse

PRISHTINË, 16 TETOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka marrë pjesë në aktivitetin “Energji për barazi”, i organizuar nga MCC/MCA Kosovë, i cili synon fuqizimin e grave në sektorin e energjisë në Kosovë.

Aktiviteti “Energji për barazi” realizohet në kuadër të projektit Përhshpejtimi i Tranzicionit të Drejtë dhe të Barabartë “JETA”, që ka synim rritjen e përfaqësimit të gruas në sektorin e energjisë dhe sektorët e ngjashëm përmes promovimit të praktikave të barabarta gjinore brenda kompanive, mbështetjes së rrjetëzimit, mentorimit dhe mundësive të trajnimit për gratë, fuqizimit të mundësive arsimore, ofrimin të ndihmës teknike dhe granteve të vogla për punëdhënësit në sektorin e energjisë dhe sektorë të ngjashëm.



Sa i përket përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse kyçe, ministrja Rizvanolli theksoi se Kosova është me fat që ka shumë gra e vajza që janë shembull për

vajzat e reja. Ajo vlerësoi se përmes politikave aktive të tregut të punës, përkrahjes së bizneseve të grave, përmes bursave e përkrahjeve për vajzat dhe gratë, e

shumë masave të tjera afirmative, mbështetja për gratë është vë në qendër të politikave dhe synimeve qeverisëse. “Sektori i energjisë i cili tradicionalisht ka qenë i dominuar nga burrat, ka përjetuar ndryshime të mëdha në dekada të fundit, mirëpo pavarësisht prej progresit e ndryshimeve teknologjike, gratë vazhdojnë që të jenë të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse dhe në role të tjera teknike. Kjo jo vetëm që është një padrejtësi, por është një kufizim për vetë sektorin dhe ekonominë, sepse kështu kufizon potencialin e plotë dhe inovacionin e një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë”, tha Rizvanolli.

Lidhur me rritjen e pjesëmarrjes së grave në sektor të energjisë, ministrja Rizvanolli theksoi se kemi shumë gra të suksesshme edhe inxhinierë shumë të zonja në

sektor, mirëpo fakti është që ka përfaqësim të ulët, veçanërisht në pozita udhëheqëse, andaj aty kemi filluar të bëjmë ndryshime. Ministria Rizvanolli shtoi se projekti “Energji për barazi” është edhe një shembull se si specifikisht në sektorin e energjisë, mirëpo edhe në profesione që ndërlidhen me sektorin e energjisë do të promovohet punësimi dhe shkathësitë e grave. “Me ‘Energji për barazi’ do të sigurohemi që gratë përfshihen e kontribuojnë në sektorin e energjisë, duke përkrahur gratë e vajzat për të zhvilluar karrierë në energji përmes trajnimit, mentorimit e rrjetëzimit, nga ana tjetër duke nxitur ndërmarrjet e sektorit për të tërhequr më shumë punonjëse gra e duke ofruar kushte më të mira për të përmes përkrahjes teknike e granteve”, tha Rizvanolli.

Hapet aplikimi për programin e subvencionimit të energjisë elektrike për konsumatorët e cenusëshëm

PRISHTINË, 16 TETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se pas pilotimit me sukses gjatë vitit të kaluar, ku përfituan mbi 61 mijë familje nga subvencionimi i faturave të energjisë elektrike, kanë rihapur aplikimin për programin 2024/2025. “Të drejtë aplikimi kanë të gjitha familjet rezidente në Kosovë dhe që plotësojnë kushtet si vijon: Kanë të ardhura mesatare mujore prej më pak se 150 euro për anëtar. Pra një

familje katëranëtarëse duhet të ketë më pak se 600 euro të ardhura mujore dhe ka në pronësi më pak se 100 000 euro vlerë të paluajtshmërive”, ka thënë Murati.

Ai ka shtuar se për familjet që kualifikohen, subvencioni do të paguhet direkt në faturë, përgjatë 6 muajve të stinës së dimrit, pra për periudhën tetor 2024 deri mars 2025. “Lartësia e subvencionit do të varet nga numri i anëtarëve dhe niveli i të ardhurave

mesatare të familjes, por nuk mund të tejkalojë 50 euro në muaj. Aplikimi mund të bëhet në eKosova, te shërbimi ‘Grante dhe subvencione’, dhe do të jetë i hapur në vazhdimësi përgjatë programit. Në mënyrë që të përfitoni që nga muaji i parë, duhet të aplikoni më së largu deri më 31 tetor. Aplikimet që bëhen pas fundit të muajit mund të përfitojnë vetëm nga muaji pasues e tutje”, ka thënë Murati.



PE-ja synon t'i afrojë vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, më pranë Këshillit të Evropës dhe BE-së



Shkruar nga:
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Parlamenti Evropian (PE) ka luajtur një rol të rëndësishëm në afrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian (BE), duke përfshirë edhe Kosovën. PE-ja ka ndërmarë hapa të veçantë për të mbështetur Kosovën në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE. Një nga çështjet kyçe ku PE-ja ka ofruar mbështetje të fuqishme është liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Në korrik të vitit 2018, Komisioni Evropian konfirmoi se Kosova kishte përmbushur të gjitha kriteret e nevojshme, përfshirë sundimin e ligjit dhe luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, procesi mbeti i bllokuar në Këshillin e BE-së për shkak të hezitimit të disa vendeve anëtare. Gjatë periudhës 2019-2022, PE-ja ka miratuar rezoluta duke i bërë thirrje Këshillit të BE-së të aprovonte liberalizimin e vizave për Kosovën, duke theksuar padrejtësinë që i bëhej qytetarëve

të saj, si vendi i vetëm në rajon pa liri lëvizjeje pa viza në zonën Schengen. Në vitin 2022, nën udhëheqjen e raportueses për Kosovën, Viola von Cramon, PE-ja intensifikoi përpjekjet për të ushtruar presion mbi shtetet anëtare skeptike. Si rezultat, në vitin 2023, Këshilli Evropian miratoi një datë për liberalizimin e vizave, me finalizimin e procesit të parashikuar për fundin e vitit 2023 dhe fillimin e vitit 2024, gjë që u realizua më 1 janar 2024.

PE-ja ka mbështetur edhe dialogun ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me qëllim aritjen e një marrëveshjeje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve. Në maj 2021, PE-ja miratoi një rezolutë që i bëri thirrje Serbisë të ndalojë fushatën për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se njohja reciproke është e domosdoshme për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në rajon. Marrëveshja e Ohrit mes Kosovës dhe Serbisë, e cila synonte njohjen e simboleve shtetërore të Kosovës nga Serbia, përbën një hap të rëndësishëm drejt paqes rajonale dhe integritetit të të dy vendeve në BE. Përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), PE-ja ka siguruar mbështetje financiare për projekte kyçe në Kosovë. Në vitin 2021, Kosova përfitoi 78.4 milionë euro për projekte në sek-

torin e energjisë së rinovueshme dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, të cilat synojnë përmirësimin e rrjetit energjetik dhe infrastrukturës. Për më tepër, përmes Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, BE-ja ka ndarë fonde shtesë për ndërtimin e një linje të re energjetike midis Kosovës dhe Shqipërisë, duke forcuar sigurinë energjetike të të dy vendeve dhe integrimin rajonal.

Në vitin 2023, PE-ja miratoi një nismë për të lejuar vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, të integrohen gradualisht në tregun e përbashkët të BE-së. Kjo përfshin qasje në katër liritë kryesore të BE-së: lirinë e lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve, duke i dhënë mundësi Kosovës të përfitojë nga tregtia e lirë me BE-në dhe të tërheqë investime të huaja.

Një tjetër fushë ku PE-ja ka ushtruar ndikim është forcimi i institucioneve demokratike dhe sundimi i ligjit në Kosovë. Në vitin 2020, PE-ja vlerësoi përparimin e Kosovës, por kritikoi vonesat në proceset gjyqësore dhe mungesën e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit, duke kërkuar reforma të thella për të rritur pavarësinë dhe transparencën e sistemit gjyqësor. PE-ja ka si qëllim të mbështesë Kosovën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e

Evropës. Ky institucion është një nga më të rëndësishmit për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit në Evropë, dhe anëtarësimi i Kosovës do të ishte një hap i madh në përpjekjet e saj për integrim evropian.

Më 17 maj 2024, Kosova ishte pranë marrjes së një vendimi kyç nga Këshilli i Evropës për anëtarësimin e saj. Pas një rekomandimi pozitiv nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në prill 2024, ku 131 deputetë votuan në favor të anëtarësimit të Kosovës, Komiteti i Ministrave kishte planifikuar të japë vendimin përfundimtar më 16 dhe 17 maj 2024. Megjithatë, për të marrë këtë vendim, Kosova do të duhej të siguronte një shumicë prej dy të treshash në votimin e Komitetit të Ministrave, ku janë përfaqësuar ministrat e jashtëm të vendeve anëtare. Ka një mbështetje të gjerë për anëtarësimin e Kosovës, por disa vende kërkojnë progres në krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si një kusht pas-anëtarësim për t'u plotësuar. Ndërkohë, Serbia ka kundërshtuar dhe kundërshton fuqishëm anëtarësimin e Kosovës, duke kërcënuar me pasoja në marrëdhëniet dypalëshe dhe rajonale nëse Kosova bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. Mbështetja e PE-së për Kosovën është pjesë e përpjekjeve më të


gjera për të afruar Ballkanin Perëndimor me strukturat evropiane, duke ndihmuar reformat e brendshme dhe duke i dhënë Kosovës një platformë për pjesëmarrje në vendimmarrjet evropiane. Përfshirja në Këshillin e Evropës do t'i jepte Kosovës më shumë mundësi për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të saj dhe për të rritur standardet demokratike.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është mbështetur dhe do të duhej mbështetur nga shumë vende evropiane dhe institucione ndërkombëtare, por procesi ende përballet me sfida për shkak të mosnjohjes së saj nga disa shtete anëtare.

Parlamenti Evropian (PE) ka shprehur vazhdimisht interes për integrimin e Kosovës në strukturat evropiane, duke mbështetur proceset që e afrojnë Kosovën me Bashkimin Evropian. PE-ja ka qenë një zë i fuqishëm në favor të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe ka inkurajuar vazhdimisht përparimin e Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Megjithatë, procesi i anëtarësimit mbetet i varur nga disa shtete anëtare të BE-së që kanë rezerva për pranimin e Kosovës, përfshirë mosnjohjen e saj nga pesë vende anëtare. PE-ja, megjithatë, mbetet një nga mbështetësit më të mëdhenj të integritetit të Kosovës në strukturat evropiane.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Zumberi: Ndihem superior ndaj kundërshtarëve, synoj majat në sport

Sportisti Denis Zumberi është shqiptari i radhës që ka filluar të shkëlqejë në botë. Ai ka filluar të korrë dalëngadalë suksese. Ka regjistruar katër fitore në po aq “luftëra” të zhvilluara në sportin e arteve të përziera marciale. Denisi synon t’i arrijë majat në këtë sport, derisa një ditë të zhvillojë edhe një meç në Kosovë

“Epoka e re”

PRISHTINË, 16 TETOR - Denis Zumberi është një tjetër sportist shqiptar që po ndriçon në botë. Denisi, një sportist gjigant, ka lindur dhe është rritur në Gjermani, por prejardhja e tij është nga Kosova, përkatësisht Peja. Edhe Denisi si shumë shqiptarë të tjerë dashurinë për sportet luftarake e ka në zëmër. Këtë e trashëgoi nga babai Valoni. Ky i

boksi nuk është një sport për mua, pasi duhet të presësh shumë për meçin e radhës”, ka thënë Zumberi, i cili më pas kalon në sportin e Arteve të Përziera Marciale (MMA). Në këtë rrugëtim të ri Denisi ka zhvilluar katër lufta dhe të katërtat i ka fituar. Të fundit në një turnir në Sloveni fitoi dy gara, Angelo Horinin e mposhti për 1 minutë e 30 sekonda dhe Potočnik Blaz pas tre raundeve. “Jam shumë i përgatitur dhe këtë e dëshmoja edhe në Sloveni.



është aspak lehtë të merresh me këtë sport, por kur ke besim në vete dhe përgatitja nuk të mungon, atëherë gjithçka është e thjeshtë. Ndaj kundërshtarëve në të shumtën e rasteve ndihem superior”, ka deklaruar Zumberi, i cili planifikon t’i zhvillojë edhe një apo dy luftëra në amatorë e më pas të kalojë në profi.

Më pas sportisti 23-vjeçar ka folur edhe për sportistët e shumë shqiptarë që po lënë gjurmë në botë. “I përcjell shumicën e sporteve kur kam kohë të lirë dhe shoh çdo ditë e më shumë shqiptarë që lënë gjurmë me suksese të jashtëzakonshme nëpër botë. Kjo është një gjë e mirë se po kallëzojmë se jemi një popull që luftojmë dhe nuk dorëzohemi asnjëherë për t’i arritur synimet”, ka shtuar ai.

Denisi asnjëherë nuk pushon së dashuruar Kosovën dhe Shqipërinë. Në këtë bisedë ai ka

treguar se çdoherë kur ka pushim e viziton vendin e prejardhjes dhe këtu thotë se mbushet me energji. “Dua të jam i sinqertë, se vetëm në Kosovë plotësohem në shpirt. Sa herë kam pushim vij me dëshirën më të madhe. Këtu është vendi im. Po ashtu, është një pjesë e madhe e

mirëpritja, e cila nëpër shumë vende të botës mungon”, ka treguar Denisi. “Kam vizituar të gjitha qytetet e Kosovës, por edhe shumë të Shqipërisë. Di edhe nga historia dhe për vuajtjet e popullit shqiptar. Këtë e trashëgoi nga familja që ka dhënë kontribut në rrugën për




fundit në vitet 1993-1994 ishte marrë me sportin e kikkboksit, por një lëndim e kishte penguar të vazhdojë më tutje. “Sportet luftarake janë në gjenet e mia. Vetëm po e vazhdoj rrugën e babait tim dhe për këtë jam shumë krenar. Shpresoj që në të ardhmen me suksese të mëdha ta gëzoj familjen dhe shqiptarët”, ka thënë Zumberi në një bisedë për “Epokën e re”.

Fillimisht 23-vjeçari ka filluar me sportin e budingut, duke arritur të gjitha synimet, më pas ka kaluar në sportin e boksit. Pas një fitore ai kishte filluar të merrej intensivisht me përgatitje për gjashtë muaj për meçin e dytë në karrierën e tij, por vetëm dy ditë para këtij meçi kundërshtari e anuloi dhe kjo ishte një thyerje për shqiptarin Zumberi. “Isha përgatitur në maksimum, duke mos kursyer asgjë. Anulimi më ka thyer pasi për muaj të tërë isha marrë vetëm me përgatitje dhe këtu mendova se

Thjesht jam një ‘tanke’ dhe i papërbalueshëm për kundërshtarët”, ka shtuar ai, duke folur edhe për sportin e Arteve Marciale të Përziera (MMA). “Nuk



familjes dhe njerëzit janë shumë të dashur. Çdo kund ekziston



çlirim. Axha ynë, atdhetari Hamid Zumberi, ishte plagosur në protesta për padrejtësitë ndaj popullit shqiptar, e deri te lufta e fundit çlirimtare ku nuk mungoi kontributi. Prandaj me dëshirë e vizitoj Prekazin, vendin e rënies së komandantit legjendar me familje. Një sakrificë që në pak vende të botës mund ta dëgjosh. Pastaj edhe vendet e tjera ku trimat me fljimin e tyre sollën lirinë. Kjo histori e vendit tim është edhe një motiv i madh për mua si shqiptar të luftoj drejt ngritjes sa më lart në këtë sport”, ka shtuar Zumberi. Në fund sportisti Denis Zumberi ka zbuluar edhe një dëshirë të madhe që e ëndërron ta realizojë në karrierën e tij. “Përveç sukseseve që synoj t’i arrij në sport, dëshira ime e madhe është që një ditë të zhvilloj një meç në Kosovë, pse jo në Pejë”, ka përfunduar Zumberi.

Norris: Jam gati të dueloj me Verstappenin deri në fund për titullin

BRISTOL, 16 TETOR - Kampionati botëror i Formulës 1 po hyn në fazat e tij më të nxehta dhe tifozët nuk janë në gjendje të vendosin se cili do ta fitojë titullin, Lando Norris me McLarenin apo Max Verstappenin me Red Bullin. Holandezi ka në krah përvojën e kampionit dhe avantazhin prej

52 pikësh në renditje, ndërkohë që janë edhe 6 gara për t'u zhvilluar, duke nisur nga ajo e kësaj fundjave në pistën e Austin në Amerikë. "Më pëlqen të garoj në Austin. Është një garë e shkëlqyer për ta nisur pjesën e fundit të sezonit pas disa javësh pushim. Është, gjithashtu, një fundjavë sprint, që do të thotë

se ka më shumë pikë për t'u rrëmbyer", u shpreh piloti britanik Lando Norris. Më tej, pilot i McLarenit, shton: "Kam kaluar disa kohë në Qendrën Teknologjike të McLarenit duke simuluar, për t'u përgatitur për tri garat e ardhshme. Dy muajt e ardhshëm do të jenë tepër të ngarkuar, por edhe emocionues.

Unë jam gati të kthehem në makinë dhe t'i tregoj se çfarë mund të bëjmë". "Ne po kalojmë një moment të jashtëzakonshëm, ndaj duhet të shfrytëzojmë këtë avantazh. Jam gati të dueloj me Max deri në garën e fundit të sezonit për titullin për pilotë, por edhe për atë konstruktorë. Le të



përpiqemi ta bëjmë këtë gjë duke nisur nga gara e ardhshme në Austin", ka thënë Norrisi.

FFK dhe FIFA diskutojnë praktikën financiare për mirëqeverisje dhe zhvillim të qëndrueshëm

PRISHINË, 16 TETOR - Është mbajtur të mërkurën një takim i rëndësishëm në mes të Departamentit të Financave të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Departamentit të Financave për Mirëqeverisje të FIFA-s. Ky takim kishte për qëllim diskutimin e thellë mbi praktikën financiare të FFK-së, si dhe analizën e gjendjes aktuale financiare. Në këtë kuadër, u theksua roli thelbësor që FIFA ka luajtur dhe vazhdon të luajë në mbështetjen e FFK-së për zbatimin e praktikave të qëndrueshme dhe të rregullta financiare, duke siguruar një transparencë dhe efikasitet më të madhe në administrimin e fondeve. Në këtë u ndan përvojat dhe ekspertizat e dy organizmave në lidhje me përmirësimin e proceseve financiare. Christoph Suppiger, shefi i Programit për Mirëqeverisje Financiare të FIFA-s, Vasco Stock da Cunha, koordinator Rajonal për Evropën dhe Manuel



Moreira, koordinator për Mirëqeverisje Financiare, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me federatat kombëtare, për të siguruar qëndrueshmëri dhe përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit financiar. Nga FFK-ja në takim, krahas presidentit Agim Ademi, ishin edhe Agim Gashi, shefi i

Departamentit të Financave, Lumnije Ymeri, zyrtare financiare, Doruntinë Fetahaj, koordinatorë e programit FIFA Forward dhe UEFA Hatrick, si dhe Indrit Canolli, koordinator i programit FIFA Forward dhe UEFA Hatrick, të cilët prezantuan gjendjen aktuale financiare dhe prioritetet për zhvillimin e ardhshëm.

Tucheli emërohet trajner i Kombëtares së Anglisë

LONDËR, 16 TETOR - Gjermani Thomas Tuchel është emëruar trajner i ri i Kombëtares së Anglisë në futboll. Kjo u njoftua zyrtarisht të mërkurën nga Federata e Futbollit (FA). Sipas medieve britanike, Tuchel ka nënshkruar një kontratë 18-mujore, e cila hyn në fuqi më 1 janar 2025 dhe do të zgjasë deri në fund të Kupës së Botës 2026. Thomas Tuchel bëhet trajneri i tretë i huaj që drejton Anglinë pas suedezit Sven Eriksson dhe italianit Fabio Capello. Tuchel, i cili u largua nga Bayern Muncheni në fund të sezonit të kaluar, u shpreh se: "Jam shumë krenar që më është dhënë nderi ta drejtoj ekipin anglez. Ta kesh mundësinë për ta përfaqësuar Anglinë është një privilegj i madh dhe mundësia për të punuar me këtë grup lojtarësh të veçantë dhe të talentuar është shumë emocionuese". Trajneri anglez Anthony Barry do



të jetë ndihmësi i Tuchelit, i cili drejtoi Mainzin, Borussia Dortmundin, Paris St-Germain dhe Chelsea përpara se të transferohej te Bayern Muncheni.

Anglezi Gareth Southgate dha dorëheqje në korrik pas humbjes së Anglisë kundër Spanjës në finalen e "Euro 2024", kompeticion ky, i cili u mbajt në Gjermani.

SHKURT

Amir Rrahmani në formacionin e Ligës së Kombeve

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, bëri një paraqitje mbresëlënëse ndaj Qipros në Ligën e Kombeve. Mbrotjtësi "dardan" realizoi golin e parë në fitoren 3-0. Për paraqitjen e mirë, UEFA e përfshiu kapitenin në ekipin ideal të xhiros së katërt të fazës së grupeve të Ligës së Kombeve. 30-vjeçari u vlerësua me notën 8.4. Formacioni: Moris, Porro, Di Lorenzo, Rrahmani, Nagy, Alimi, Eriksen, Nanasi, Price, Gyokeres, Szoboszlai.

Istogu përballet me skuadër çeke në raundin e tretë të Kupës Evropiane

Kampioni i Kosovës në hendboll, KHF Istogu, e ka mësuar të martën pasdite kundërshtarin e raundit të tretë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Istogu do të përballet me skuadrën e njohur nga Çekia, Hazena Kynzvalt. Në raundin e tretë paraqiten 32 skuadra të hendbollisteve. Ndeshtet e para zhvillohen më 9 e 10 nëntor, ndërsa të kthimit një javë më pas. Istogu është vendas në ndeshjen e parë. Në raundin e dytë të Kupës Evropiane, istogaset e eliminuan skuadrën greke Pylaia. Ndaj skuadrës greke, Istogu i fitoi dy ndeshjet e zhvilluara në fundjavë në Pejë. Istogu për herë të tetë po paraqitet në gara evropiane. Për herë të katërt ka kaluar kundërshtarin e parë evropian. Tani kërkon ta kalojë edhe të dytin, ndonëse shorti nuk e favorizon shumë.

Messi shënon tre gola dhe shpallet 'Lojtari i ndeshjes' ndaj Bolivisë

Lionel Messi u rikthye më në fund të luajë për Argjentinën pas një periudhe prej 334 ditësh duke i argëtuar fansat specialë në fitoren 6-0 ndaj Bolivisë në kualifikimet e Botërorit 2026. Ylli argjentinas u rikthye me tre gola dhe me dy asistime, duke qenë i përfshirë në 5 gola dhe u shpall "Lojtari i ndeshjes". Futbollisti i Inter Miamit e inspiroi Argjentinën drejt fitores së radhës, ndërsa regjistroi tregolëshin e dhjetë për Kombëtaren.

Cantona për largimin e Fergusonit: Është absolutisht skandaloz

Futbollisti legjendar i Manchester Unitedit, Eric Cantona, ka reaguar ashpër ndaj lajmit se Sir Alex Ferguson është shkarkuar nga klubi "Old Trafford". Siç raporton "The Athletic", trajneri më i madh në historinë e klubit u shkarkua nga Manchester Unitedi, ku ai mbante postin e ambasadorit botëror në vitet e fundit. Ratcliffe, drejtor i konglomeratit kimik Ineos, e informoi 82-vjeçarin legjendar se ai nuk do të jetë më në listën e pagave të klubit. Ferguson është një nga 250 punonjësit që janë larguar nga puna nga Manchester United, pasi paga e tij vjetore ishte mbi 2 milionë euro. "Sir Alex Ferguson duhet të jetë në gjendje të bëjë çfarë të dojë në klub deri në vdekjen e tij. Çfarë mungesë respekti. Është absolutisht skandaloz. Sir Alex Ferguson do të jetë shefi im përgjithmonë dhe do t'i hedhë të gjithë të tjerët në një thes të madh muti", ka shkruar Cantona në rrjetet e tij sociale. Ferguson ishte trajner i Cantonas nga viti 1992 deri në 1997, dhe gjatë asaj periudhe francezi shënoi 82 gola në 185 ndeshje dhe fitoi pesë tituj të kampionatit dhe dy Kupa FA.

Haalandi si zëvendësues i Lewandowskit

Robert Lewandowski, pavarësisht prej moshës, vijon të jetë në nivele të larta, udhëheq La Ligan si golashënuesi më i mirë me 10

gola në 9 javë, por herët ose vonë edhe polaku është i detyruar të tërhiqet. "Lewa" ka një kontratë me Barcelonën deri më 2026, për

këtë arsye drejtuesit e klubit kanë nisur punën prej kohësh për të gjetur një zëvendësues. Sipas medieve spanjolle, Laporta është i

fiksuar pas idesë për ta transferuar në Barcelonë sulmuesin e Manchester Cityt, Erling Haaland. Pavarësisht prej vështirësive

ekonomike, Laporta do të bëjë gjithçka për t'i rezervuar shërbimet e Haalandit, i cili prej kohësh ndiqet edhe nga Real Madridi.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e i/e lartë për mbështetje të operimeve me Sistemet e Pagesave
Grada:	5
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Infrastrukturës së Tregut dhe Pagesave
Divizioni:	Operimit të Sistemeve
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit të Operimit të Sistemeve

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen detyrat e parapara në kuadër të procedurave operacionale ditore të punës me Sistemet e Pagesave-KIPS, dhe mbështetje të përdoruesve;
- Bashkëpunon dhe koordinon me Departamentin e Teknologjisë Informative/BQK, në raste të ngritjes së problemeve të natyrës teknike/operacionale apo sistemike dhe zhvillimeve të reja;
- Bashkëpunon me kompanitë kontraktuese, në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve, ngritjes (zhvillimeve shtesë) së funksioneve shtesë dhe testeve të sistemeve ekzistuese;
- Ofron trajnime për pjesëmarrësit e rinjë dhe ndihmon në përgatitjen teknike për këta pjesëmarrës;
- Angazhohet në realizimin e detyrave për punë operuese në KIPS për rastet e jashtëzakonshme dhe ofron zgjidhje teknike;
- Angazhohet në përgatitjen e dokumenteve (rregullore, manuale të përdorimit, udhëzime teknike, procedura, etj) për sistemet e DITP-së;
- Angazhohet në përgatitjen e raporteve, procedurave dhe standardeve të ndërlidhura me menaxhimin e rrezikut operacional;
- Duhet të jetë e njohur me të gjitha funksionet e sistemeve të DITP-së, dhe angazhohet në realizimin e të gjitha detyrave dhe punëve që kërkohen lidhur me funksionimin e rregullt të tyre;
- Komunikon dhe koordinon aktivitetet me departamentet dhe divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin për mbarëvajtjen e operacioneve me sistemet e DITP-së;
- Komunikon dhe ofron konsultat sipas nevojës për pjesëmarrësit e sistemit të pagesave, si dhe për palët e treta;
- Monitoron dhe ofron zgjidhje për funksionet teknik që lidhen me sistemet e DITP-së.
- Angazhohet në përcjelljen e zhvillimeve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave në BE e më gjerë, me standardet e mesazheve financiare, si dhe në analizimin dhe propozime për avancimin e funksioneve të sistemeve të pagesave;
- Angazhohet në monitorimin e veglave të ndryshme teknike të ndërlidhura me sistemet e DSP, si dhe përgatitjen e skriptave për filtrim të raporteve të njohura nga baza e të dhënave;
- Sipas nevojë kryen punë të tjera të lidhura me sistemet që operohen në kuadër të DITP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësi në DITP dhe BQK.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e IT-së, inxhinierisë, ekonomisë (në drejtimet menaxhment dhe informatikë apo banka dhe financa);
- Përvojë prej së paku tre (3) viteve me aplikacione/sisteme kompjuterike, drejtpërdrejt të ndërlidhura me infrastrukturën për shërbimet e pagesave apo për shërbimet tjera financiare, me preferencë përvoja në sektorin bankar;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë dhe njohuri në administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve të pagesave ndër-bankare si dhe mesazhet financiare të përdorura në këto sisteme;
- Shkathësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe adaptim të shpejt me zhvillimet e reja;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të avancuara të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës** (Trusti) për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raportin nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim **01 nëntor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Viši/a službenik/ca za podršku operacijama platnih sistema
Stepen pozicije:	5
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Tržišne i platne infrastrukture
Odsek:	Operacije sistema
Izveštava:	Šefu Odseka za operacije sistema

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja poslove predviđene u okviru dnevnih operativnih procedura rada sa Platnim sistemima-KIPS, i podršku korisnika;
- Sarađuje i koordinira sa Odeljenjem za informacione tehnologije/CBK, u slučajevima pojavljivanja tehničkih/ operativnih ili sistemskih problema i novih odvijanja;
- Sarađuje sa ugovornim kompanijama u cilju održavanja sistema, (dodatnog) razvijanja dodatnih funkcija i testiranja postojećih sistema;
- Pružava obuku za nove učesnike i pomaže u tehničkoj pripremi ovih učesnika;
- Angažuje se na obavljanju zadataka za operativni rad u KIPS-u za izuzetne slučajeve i nudi tehnička rešenja;
- Angažuje se na pripremu dokumentacije (uredbi, priručnika za upotrebu, tehnička uputstva, procedura itd.) za DITP sisteme;
- Angažuje se na pripremi izveštaja, procedura i standarda koji se odnose na upravljanje operativnim rizikom;
- Treba biti upoznat/a sa svim funkcijama DITP sistema i angažuje se u obavljanju svih dužnosti i poslova koji se zahtevaju u vezi sa njihovim redovnim funkcijom;
- Komunicira i koordinira aktivnosti sa drugim odeljenjima i odsecima CBK-a u vezi sa zahtevima i potrebama koje proizilaze za nesmetano odvijanje operacija sa DITP sistemima;
- Komunicira i daje savete po potrebi za učesnike platnog sistema kao i za treća lica;
- Prati i daje rešenja za tehničke funkcije vezane za DITP sisteme.
- Angažuje se na praćenju novih dešavanja u oblasti platnih usluga u EU-u a i šire sa standardima finansijskih poruka kao i u analiziranju i davanju predloga za unapređenje funkcija platnih sistema;
- Angažuje se na praćenju različitih tehničkih alata vezanih za DSP sisteme kao i na pripremanju skripta za filtriranje jednodimenzionalnih izveštaja iz baze podataka;
- Po potrebi obavlja i druge poslove koji se odnose na sisteme koji rade u okviru DITP-a, delegirane od strane nadzornika ili više hijerarhije ili sa obavezama koje proizilaze iz odgovornosti u DITP-u i u CBK-u.

Stručna sprema/ kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma u oblasti IT-a, inženjerstva, ekonomije (u smerovima upravljanje i informatika ili bankarstva i finansija);
- Iskustvo od najmanje tri (3) godine sa računarskim aplikacijama/sistemima, direktno povezanim sa infrastrukturom za platne usluge ili za druge finansijske usluge, poželjno je iskustvo u bankarskom sektoru;
- Prednost imaju kandidati sa iskustvom i znanjem u administraciji i tehničkoj podršci međubankarskih platnih sistema kao i finansijskim porukama koje se koriste u ovim sistemima;
- Organizacione veštine, veštine u planiranju i upravljanja vremenom;
- Međuljudske i komunikacijske veštine kao i sposobnosti za rešavanje problema i brzo prilagodavanje u novim dešavanjima;
- Tačnost, pažnja na detalje kao i osjetljivost na prioritete;
- Napredno poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo gde je naglašeno interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda** (Trusta) za dotični period ili poresku potvrdu iz Poreske administracije (PAK) kada izveštaj iz Trusta ne bude zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/ kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **01 novembar 2024. godine**.
- Prijava se može izvršiti preko interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a, ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Raportime Financiare
Grada e pozitës:	Gjashte (6)
Kohëzgjatja e punësimit:	Me afat të pacaktuar
Divizioni:	Divizioni i Buxhetit dhe Raportimit Financiar
Departamenti:	Departamenti i Financave
Raporton të:	Udhëheqësi i Divizionit të Buxhetit dhe Raportimit Financiar

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përgatit pasqyrat financiare dhe raportet periodike financiare, si dhe raportet tjera analitike që ndihmojnë në përgatitjen e pasqyrave financiar;
- Përgatit bilancin provues, kryen verifikimet testuese apo barazuese të librit kryesor të llogarive dhe themelon një konsistencë të llogarive të librit kryesor;
- Ndihmon në rishikimin dhe hartimin e politikave dhe procedurave me referencë të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe kontabilitetit, legjislacionin, dhe politikave të procedurave relevante të BQK-së si dhe praktikave të mira;
- Siguron përputhshmërinë me legjislacionin relevant, me politika dhe procedurat e BQK-së gjatë realizimit të përgatitjes së pasqyrave dhe raporteve financiare;
- Mbikëqyrë mbylljen e muajit, dhe mbylljen e vitit si dhe procedurat përkatëse që ndërlidhen me këto aktivitete;
- Zëvendëson *personelin tjetër të Divizionit të Buxhetit dhe Raportimit Financiar sipas autorizimeve të vijës raportuese;*
- Kryen punë të tjera në kuadër të departamentit sipas kërkesës së vijës raportuese.

Njohurit e kërkuara:

- Diploma e Universitetit në Ekonomi/ks, Financa, Kontabilitet, Menaxhim Afarist apo Matematikë Financiare dhe të ngjajshme,
- Preferohet të ketë certifikim në kontabilitet (në shoqatat profesionale vendore dhe/ose ndërkombëtare),
- Njohuri të mira të punëve bankare paraqet përparësi,
- Njohuri të mira në Excel dhe Word, si dhe preferohet të ketë përvojë pune me aplikacione (bankare) të raportimit financiar dhe kontabilitetit,
- Preferohet njohuri të mira të Gjuhës Angleze;

Përvoja e kërkuar:

- Kërkohej së paku dy (2) vite përvojë pune në raportime financiare, bankë/financa/buxhetim ose kontabilitetin financiar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **01 nëntor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Službenik za finansijsko izveštavanje
Stepen pozicije:	Šest (6)
Trajanje zaposlenja:	Sa neodređenim rokom
Odsek:	Odsek za budžet i finansijsko izveštavanje
Odeljenje:	Odeljenje za finansije
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za budžet i finansijsko izveštavanje

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Priprema finansijske izveštaje i periodične finansijske izveštaje, kao i druge analitičke izveštaje koji pomažu u pripremanju finansijskih izveštaja;
- Priprema probni bilans, vrši probne ili verifikacije usaglašavanja glavne knjige računa i uspostavlja konzistentnost računa glavne knjige;
- Pomaže u pregledu i izradi nacrtu politika i procedura u vezi sa međunarodnim finansijskim izveštajima i računovodstvenim standardima, zakonodavstvom i relevantnim politikama i procedurama CBK-a, kao i dobrim praksama;
- Obezbeđuje usklađenost sa relevantnim zakonodavstvom, politikama i procedurama CBK-a tokom pripreme finansijskih izveštaja;
- Nadzire zatvaranje meseca i zatvaranje godine, kao i relevantne procedure u vezi sa ovim aktivnostima;
- Zamenjuje *drugo osoblje Odseka za budžet i finansijsko izveštavanje prema ovlašćenjima linije izveštavanja;*
- Obavlja i druge poslove u okviru odeljenja po zahtevu izveštajne linije.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije/ksa, finansija, računovodstva, poslovnog menadžmenta ili finansijske matematike i slično,
- Poželjna je sertifikacija iz računovodstva (u lokalnim i/ili međunarodnim profesionalnim udruženjima),
- Dobro poznavanje bankarskih poslova je prednost,
- Dobro poznavanje Excel-a i Word-a, kao i poželjno je iskustvo u radu sa (bankarskim) aplikacijama za finansijsko izveštavanje i računovodstvo,
- Poželjno je dobro poznavanje engleskog jezika;

Potrebno iskustvo:

- Potrebno je najmanje dve (2) godine radnog iskustva u oblasti finansijskog izveštavanja, bankarstvo/finansije/budžetiranje ili finansijsko računovodstvo.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **01 novembar 2024**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Ostali oblici apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT


SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Zvogëlim kapitali nga "KFF EP HAJVALIA"

"KFF EP HAJVALIA" SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 811579509, bënë njoftim në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 150,000.00 €uro në vlerën 5,000.00 €uro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valentin Gojani nga Gramaqeli KK Deçan, shpall të pavlefshme shpall të pavlefshme certifikatën e aftësisë profesionale të sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Mirlind Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Dion Kazazi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Danjell Gjini shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- Saide Likaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.
- Nashide Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- Majlind Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10 të shkollës së mesëm Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



